

VENDIM
Nr.152, datë 29.12.2014

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI SHA”NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET“GOJAN”, “GJEGJAN”, “PESHQESH” DHE “FANGU”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasishqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji sh.a.” plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5 janë plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Gojan” me fuqi të instaluar 12,25 MW, “Gjegjan” me fuqi të instaluar 6,55 MW, “Peshqesh” me fuqi të instaluar 27,94 MW dhe “Fangu” me fuqi të instaluar 63,8 MW

(Me fuqi totale 110.54 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti